



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**  
**Sesioni pranveror**

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale  
Mbledhja nr. 39  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 302  
Prishtinë, më 10 prill 2019, në orën 10:00

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Besa Baftiu, Enver Hoti, Haxhi Avdyli, Naser Rugova, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, Bekim Haxhiu, Flora Brovina dhe Time Kadrijaj.

**Munguan:** Miljana Nikoliq, Drita Millaku dhe Fikrim Damka.

**Pjesëmarrës tjerë:** Ilir Hoxha – KDI, Faruk Kukaj – HANDIKOS, Edmond Miftari – HANDIKOS dhe mediat.

**Mbledhjen e kryesoi:** Besa Baftiu, kryetare e Komisionit.

**RENDI I DITËS:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 27.2.2019 dhe 20.3.2019;**
- 3. Raportimi i grupeve punuese për projektligjet në procedurë;**
- 4. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

## **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 27.2.2019 dhe 20.3.2019;**

Procesverbali i mbledhjes së datës 27.2.2019 dhe 20.3.2019, u miratua pa asnjë ndryshim.

## **3. Raportimi i grupeve punuese për projektligjet në procedurë;**

**Besa Baftiu, kryetare,** tha se sa i përket planit të punës, nuk jemi në hapat e duhur dhe tregoi se në procedurë Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale i ka dy projektligje; atë të Inspektoratit të Punës dhe atë të Këshillit Ekonomik Social. Po ashtu, ajo përmendi monitorimin e Ligjit për produkte dhe pajisje medicinale dhe diskutoi rreth formimit të grupeve punuese, ku secili grup e ka kryesuesin e tij dhe meqenëse të gjithë anëtarët e komisionit nuk janë pjesë të grupeve punuese, Baftiu theksoi se si Komision duhet të jemi në dijeni për punët dhe aktivitetet që kryhen rreth amendamentimit të këtyre projektligjeve, gjegjësisht edhe për monitorimin e Ligjit për produkte dhe pajisje medicinale. Ajo tha se puna duhet të përshpejtohet, duke filluar që nga Projektligji për Inspektoratin e Punës, ku kryesues i grupit punues është deputeti Bekim Haxhiu.

Baftiu njoftoi se projektligji është miratuar në parim në Kuvendin e Kosovës më 25.10.2018 dhe grupi punues është formuar më 8.11.2018, ndërsa foli për vizitën në Slloveni dhe diskutoi rreth planifikimit të datës së përfundimit të punës së grupeve punuese.

**Bekim Haxhiu,** tha se pas vizitës në Slloveni, grupi punues ka në plan të ulet edhe njëherë dhe të rishikojë projektligjin në tërësi. Ai shprehu gatishmërinë që grupi punues të punojë intenzivisht dhe projektligji shumë shpejt të përfundohet dhe të procedohen amendamentet për miratim në Komision.

**Besa Baftiu,** tha se për monitorimin e Ligjit për produkte dhe pajisje medicinale, i cili është në përfundim, informata më të hollësishme do t'i paraqes kryesuesi i grupit punues, Naser Rugova.

**Naser Rugova,** tha se si grup punues për monitorimin e Ligjit për produkte dhe pajisje medicinale është përmbushur vorbulla e paraparë e vizitave dhe biseda me institucione përmes mekanizmave të caktuar. Ai përmendi dy vizitat e fundit, gjegjësisht në Odën e Farmacistëve të Kosovës dhe Inspektoratin Farmaceutik, ku theksoi se grupi punues ka marrë informata të dobishme dhe orientim për ligjin e ardhshëm, ku në fakt do të vendoset se a do të bëhet plotësimi dhe ndryshimi, apo ligj i ri.

Rugova falënderoi kryetaren dhe kolegët që morën pjesë në të gjitha takimet dhe vizitat të cilat ky grup punues i pati me institucione dhe fokus grupe të caktuara dhe shtoi se deri në fund të muajit, beson se raporti do të jetë i gatshëm.

**Besa Baftiu,** njoftoi anëtarët e Komisionit se në një takim i cili është organizuar nga KDI-ja, rreth punës njëvjeçare të Kuvendit të Kosovës, Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, ishte i vetmi komision nga të gjithë komisionet, i cili ka monitoruar ligj në vitin që e lamë pas.

**Enver Hoti**, tha se grupi punues është në proces të amendamentimit të plotësim-ndryshimit të Projektligjit për Këshillin Ekonomik Social. Ai theksoi se është mbajtur edhe dëgjimi publik, ku të gjitha fokus grupet të cilat kanë interes, kanë dhënë maksimumin në këtë përmirësim, i cili do të rezultojë pas këtij aktiviteti. Po ashtu, është mbajtur edhe një punëtori, ku tha se është bërë një punë e palodhshme dhe tash jemi në përmbyllje të kësaj faze. Hoti tha se do të mbahet edhe një takim për ta prezantuar punën e cila është bërë në emër të grupit punues, për të rishikuar, përmbledhur dhe konsultuar disa elemente me grupet e deputetëve dhe subjektet e tyre.

#### **4. Të ndryshme.**

**Besa Baftiu, kryetare**, njoftoi anëtarët e Komisionit për marrjen e raportit të vizitës që u bë në Slloveni. Në këtë udhëtim nuk patën mundësi të marrin pjesë të gjithë anëtarët e Komisionit, pasi që ky udhëtim është sponsoruar nga IKS-i dhe FES-i, prandaj, pjesëmarrës kanë qenë vetëm anëtarët e grupit punues të Projektligjit për Inspektorat të Punës. Kjo vizitë ka qenë e frytshme për Komisionin, për shkak të shkëmbimit të përvojave dhe marrjes së informative të detajuara, jo vetëm për projektligjet të cilat vijnë nga marrëdhënia e punës, mirëpo edhe takimi me drejtorin e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore. Kryetarja po ashtu, ngriti si çështje edhe vizitat qoftë në objekte shëndetësore apo sociale, duke pasur parasysh që Komisioni ka pasur kërkesë qysh moti që të vizitohet Instituti i Mjekësisë së Punës në Obiliq si dhe Shtëpia e Pleqve në Prishtinë. Këto dy vizita është mirë që të kryhen gjatë këtij muaji dhe pastaj të bëhet si rutinë që çdo muaj të vizitohen së paku dy institucione.

**Naser Rugova**, tha se kanë prioritet dy grupet punuese, por duhet të dakordohemi rreth mbajtjes së grupeve punuese. Instituti i Mjekësisë së Punës në Obiliq ka qenë një nga institucionet më kredibile të, mirëpo, kanë ngelur keq. Rugova propozoi që javën tjetër, të mbahet një grup punues edhe të bëhet vizita në Obiliq.

**Haxhi Avdyli**, tha se meqenëse në mbledhjen e kaluar është diskutuar rreth situatës epidemiologjike, do të ishte mirë që të futet në agjendë edhe një vizitë në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike, për të diskutuar të gjitha sfidat e situatës epidemiologjike e cila ndodhi në Kosovë, si dhe për të parë se çfarë hapa do të ndërmarrin për vitin e ardhshëm, në mënyrë që të mos jemi të papërgatitur në sezonin kur vjen gripi dhe të ndodhë që të mos kemi vaksina dhe barna antivirale.

**Fatmire Mulhaxha- Kollçaku**, propozoi që të vizitohet Oda e Mjekëve të Kosovës, pasi që është duke u fuqizuar dhe për të parë se sa kjo odë do ta mbrojë interesin e punëtorëve shëndetësor. Ajo theksoi se ka shumë vërejtje edhe sa i përket procesit të zgjedhjes së përfaqësuesve të mjekëve në Odë, proces ky i cili është ndikuar edhe nga të përzgjedhurit e drejtorëve. Duke qenë se tani aty do të gjenerohen mjete të shumta financiare, gjegjësisht do të ketë shumë të hyra, është e rëndësishme që të monitorohet se nga do të shkojnë këto të hyra dhe a do të jenë mjekët përfitues të tyre. Ajo shprehu shqetësimin e saj rreth edukimit profesional, ku sipas saj është pika më e dobët në shtetin e Kosovës, pasi që një grup i mjekëve janë të privilegjuar në Prishtinë dhe të cilët vazhdimisht janë përfitues, qoftë nga ministritë apo fondet e ndryshme, kështu që në këtë formë ka vërejtje nga profesionistët e qyteteve të tjera të cilët nuk

kanë pasur mundësinë të sponsorohen, qoftë edhe për pjesëmarrjen për punime shkencore të cilat i kanë pasur.

Çështje tjetër është edhe vendosja e kushtit i cili është se nuk merr licencën në qoftë se dy vite nuk ushtrohet profesioni. Ajo tha se Oda e Mjekëve të Kosovës, si institucion duhet të jetë në shërbim të mjekëve, pasi që Oda është institucion i cili duhet të mbrojë mjekët.

Si çështje tjetër, ajo përmendi marrjen e informatave se çfarë po ndodhë me revidimin e listës esenciale të barnave dhe sa po respektohen sugjerimet e profesionistëve nga Kosova. Ajo tha, se edhe pse jemi të varfër si shtet dhe nuk kemi mundësi të fusim në listë barnat më të reja, megjithatë meritojmë që të kemi listë esenciale për trajtimin e sëmundjeve të rënda, pra pajisja me barna cilësore. Si pikë të fundit, ajo propozoi takimin me ministrin e Shëndetësisë z. Uran Ismaili.

**Bekim Haxhiu**, –komentoi vizitën në Qendrën Klinike Universitare dhe tha se si Komision duhet të dalim nga Prishtina, gjegjësisht të vizitohen edhe spitalet regjionale të qyteteve të tjera, në mënyrë që të evidentohen edhe problemet e tjera. Ai propozoi që të bëhet agjenda për kryerjen e këtyre vizitave dhe më pas të bëhet një raport, pasi që duhet të vrojtohet gjendja faktike e terrenit dhe jo vetëm statistikak e raporteve. A po përballen spitalet regjionale me mungesë të kuadrove? A ka rrezik që edhe ato të mbesin pa kuadro? Ai tha se shteti duhet të reagojë me një strategji, pasi që studentët e mjekësisë po e shohin veten në shërbim të një shteti si Gjermania dhe jo në Kosovë.

Çështja e dytë të cilën e diskutoi Haxhiu, ishte revidimi i listës esenciale të barnave duke konsideruar se vërehet një ngadalësim në punë dhe duhet kërkuar një raportim të Këshillit para Komisionit për të parë se ku qëndrojnë realisht. Ai po ashtu theksoi se Odat tani janë në proces të zgjedhjeve, ku disa i kanë përfunduar e disa janë ende në proces. Në këtë mënyrë problemet duhet të zgjidhen brenda Odës përmes përfaqësuesëve të tyre, pasi që janë institucione të pavarura dhe intenca ka qenë që roli i mjekut të fuqizohet përmes Odave. Sipas ligjit, 0.7% e buxhetit shkon për punime dhe hulumtime shkencore, e cila shumë duhet t'u ndahet proporcionalisht institucioneve, në mënyrë që të ketë mundësi për të bërë hulumtime shkencore si dhe të prezantohen ato. Sipas tij ky buxhet i cili garantohet me ligj, duhet të distribuohet në konsultim me ministrin e Arsimit dhe ministrin e Shëndetësisë, pasi që këto fonde po shfrytëzohen për qëllime të tjera. Ai tha se duhet të bëhet një strategji së bashku me institucionet dhe ministrinë, në mënyrë që të mos mungojnë fondet për mbështetjen e hulumtimeve shkencore.

Mbledhja përfundoi në orën 10:50

**E përgatiti:**

***Stafi Mbështetës i Komisionit***

**Kryetarja e Komisionit,**

**Besa BAFTIU**

